



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 28.1.2026

NJOFTIM PUNËSIMI

Bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, si dhe në VKM nr. 10, datë 15.1.2026, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2026, në njësitë e qeverisjes qendrore”,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin e punësimit për pozicionin vakant si mëposhtë vijon:

I. DREJTORIA E FINANCËS

➤ **SEKTORI I FINANCËS**

SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë), klasa e pagë IV-3.

➤ **Detyrat kryesore:**

- Siguron perllogaritje e saktë të listëpagesave çdo muaj.
- Rakordon me drejtoritë e tatim taksave dhe sigurimeve shoqërore.
- Llogarit dhe ndjek pagesat e raporteve të gjata në sigurimet shoqërore.
- Plotëson librin e pagesave dhe librezat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve.
- Krijon librin e pagave dhe azhuron në vazhdimësi lëvizjet e mundshme të stafit.

➤ **Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:**

1. Diplomë e nivelit “Bachelor/Master Profesional”, në Shkenca Ekonomike. Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit
4. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe mbi politikën e përbashkët për bujqësinë me BE-në.
5. Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale.

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
- Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”;
- VKM nr. 719, datë datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar
- Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në adiministratën publike”;
- Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 2.2.2026, ora 16.30 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollështa”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL